



Data	
Nr.	Prot.

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
“KOMPENSIMIN FINANCIAR PASZGJEDHOR QË DO T’U SHPËRNDAHET
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË, TË DATËS 11 MAJ 2025”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronjat “k” dhe “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për administrimin e buxhetit të KQZ-së, sipas rregullave të fushës, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Neni 89, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, parashikon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, iu kompenson fondet me shumën që rezulton nga shumëzimi i votave të vlefshme të marra prej tyre me vlerën e përcaktuar në pikën 2 të nenit 88 të Kodit.

Vendimi nr. 34, datë 28.8.2025, i Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”, përcakton subjektet zgjedhore që kanë përfutuar jo më pak se 1 % të votave të vlefshme.

Vendimi nr. __, datë __. __.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”, përcakton se vlera në para e një vote të vlefshme është 94 lekë.

Në bazë dhe për zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektakti, “Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t’u shpërndahej subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Qëllimi i këtij projektvendimi është kompensimi financiar paszgjedhor për ato subjekte zgjedhore të cilat nuk kanë përfituar nga shpërndarja e fondeve si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 maj 2023 dhe kanë marrë jo më pak se 1 përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi bazuar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Lidhja nr. 2, të Vendimit nr. 34, datë 28.8.2025, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”, partitë që kanë përfituar jo më pak se 1 përqind të votave dhe votat e vlefshme të grumbulluara prej tyre, janë si më poshtë:

1. Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore	528.592 vota	32.91%
2. Partia Lëvizja Bashkë	24.547 vota	1.53%
3. Partia Koalicioni Euroatlantik	20.885 vota	1.30%
4. Partia Socialiste e Shqipërisë	855.831 vota	53.29%
5. Koalicioni Nisma Shqipëria Bëhet	64.212 vota	4.00%
6. Partia Mundësia	48.952 vota	3.05%
7. Partia Socialdemokrate	49.865 vota	3.10%

Gjithsej Vota të Vlefshme

1.592.884 vota

Fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për financimin e fushatës zgjedhore të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 11 Maj 2025 ishte 150.000.000 lekë.

Referuar vendimit nr. 292, datë 21.3.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit që do t’u shpërndahet partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”, partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore që kanë përfituar fonde paradhënie të akorduara nga Buxheti i Shtetit në zgjedhjet e datës 11 Maj 2025, janë si më poshtë:

- Partia Demokratike – 44.818.545 (dyzet e katër milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e pesë) lekë.
- Partia Republikane – 2.689.112,70 (dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dymbëdhjetë presje shtatëdhjetë) lekë.
- Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” – 896.370,90 (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë presje nëntëdhjetë) lekë.
- Partia “Socialiste e Shqipërisë” – 65.291.390 (gjashtëdhjetë e pesë milion e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë.
- Partia e Lirisë – 9.140.730 (nëntë milion e njëqind e dyzet mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë.
- Partia “Drejtësi, Integritet dhe Unitet” – 1.792.735 (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekë.
- Partia “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” – 896.370,90 (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë presje nëntëdhjetë) lekë.
- Partia “Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë” - 896.370,90 (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë presje nëntëdhjetë) lekë.
- Partia “Lëvizja e Legalitetit” - 896.370,90 (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë presje nëntëdhjetë) lekë.
- Partia Socialdemokrate – 3.015.375 (tre milion e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

- Partia “Nisma Thurje” – 868.445 (tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë.

Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, të cilat nuk kanë përfituar fonde paradhënie dhe kanë marrë jo më pak se 1% të votave të vlefshme në shkallë vendi, janë si më poshtë:

- Lëvizja Bashkë - 1.53%
- Koalicioni “Nisma Shqipëria Bëhet” – 4.00% , partia udhëheqëse e koalicionit Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet” – 2.58 %
- Partia Mundësia - 3.05 %
- Partia Koalicioni Euroatlantik – 1.30 %.

Bazuar sa më sipër në rastin e Koalicionit “Nisma Shqipëria Bëhet” i përbërë nga 3 (tre) parti politike, ku njëra prej tyre, Partia Nisma Thurje, ka përfituar fonde publike si paradhënie për fushatën zgjedhore sipas nenit 88 të Kodit Zgjedhor, fondet si kompensim financiar paszgjedhor i përfiton Partia Lëvizja Shqipëria Bëhet, e cila ka përmbushur kushtin ligjor të kalimit të pragut prej 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi.

Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar shqyrton dhe miraton projektvendimin “Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t’u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”.

Licela VELIU	- Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit
Pavlina DOÇAJ	- Drejtoria e Ligjshmërisë
Anila RUÇO	- Sekretar i Përgjithshëm (Në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot

Data: __.__.2025

Nr:

Ora:

VENDIM

PËR

KOMPENSIMIN FINANCIAR PASZGJEDHOR QË DO T’U SHPËRNDAHET
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË, TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “k” e “n”, dhe 2, nenit 89, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 34, datë 28.8.2025, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”, si dhe **Vendimit nr. __, datë __.__.2025**, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”,

VËREJ:

Neni 89 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon kompensim financiar paszgjedhor për subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje, të cilat nuk kanë përfituar fonde sipas Vendimit nr. 397, datë 22.4.2023, “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka detyrimin t’u kompensojë fonde nga Buxheti i Shtetit atyre subjekteve zgjedhore të cilat kanë marrë jo më pak se 1% të votave të vlefshme në shkallë vendi në zgjedhjet e datës 11 Maj 2025. Referuar vendimit nr. 292, datë 21.3.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit që do t’u shpërndahet partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”, partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore që kanë përfituar fonde paradhënie të akorduara nga Buxheti i Shtetit në zgjedhjet e datës 11 Maj 2025, janë si më poshtë:

- Partia Demokratike – 44.818.545 (dyzet e katër milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e pesë) lekë.

Data: __.__.2025

Nr:
Ora:



Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t’u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 maj 2025

- Partia Republikane – 2.689.112,70 (dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dymbëdhjetë presje shtatëdhjetë) lekë.
- Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” – 896.370,90 (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë presje nëntëdhjetë) lekë.
- Partia “Socialiste e Shqipërisë” – 65.291.390 (gjashtëdhjetë e pesë milion e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë.
- Partia e Lirisë – 9.140.730 (nëntë milion e njëqind e dyzet mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë.
- Partia “Drejtësi, Integritet dhe Unitet” – 1.792.735 (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekë.
- Partia “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” – 896.370,90 (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë presje nëntëdhjetë) lekë.
- Partia “Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë” - 896.370,90 (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë presje nëntëdhjetë) lekë.
- Partia “Lëvizja e Legalitetit” - 896.370,90 (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë presje nëntëdhjetë) lekë.
- Partia Socialdemokrate – 3.015.375 (tre milion e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.
- Partia “Nisma Thurje” – 868.445 (tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë.

Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, të cilat nuk kanë përfituar fonde paradhënie dhe kanë marrë jo më pak se 1% të votave të vlefshme në shkallë vendi, janë si më poshtë:

- Lëvizja Bashkë - 1.53%
- Koalicioni “Nisma Shqipëria Bëhet” – 4.00% , partia udhëheqëse e koalicionit Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet” – 2.58 %
- Partia Mundësia - 3.05 %
- Partia Koalicioni Euroatlantik – 1.30 %.

Bazuar sa më sipër në rastin e Koalicionit “Nisma Shqipëria Bëhet” i përbërë nga Partia Lëvizja Shqipëria Bëhet, Partia Nisma Thurje dhe Partia Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë, njëra nga partitë, Partia Nisma Thurje, ka përfituar fonde sipas nenit 88 të Kodit Zgjedhor për këtë arsye për kompensim financiar paszgjedhor do merren si referim votat e Partisë “Lëvizja Shqipëria Bëhet” më vete.

Numri i votave të vlefshme në shkallë vendi, për ato subjekte zgjedhore të cilat kanë marrë jo më pak se 1% të votave të vlefshme, 1.592.884 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) vota dhe vlera 1% e tyre përlllogaritet:

$1.592.884 \cdot 0.01 = 15.928,84$ (pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e tetë presje tetëdhjetë e katër) vota.

Numri i votave të vlefshme takuese për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje e datës 14 Maj 2023, të cilat nuk përfituan fonde para zgjedhjeve është si më poshtë vijon:

- “Lëvizja Bashkë” – 24.547 vota.
- Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet” – 41.323 vota.
- Partia “Mundësia” – 48.952 vota.
- Partia “Koalicioni Euroatlantik” – 20.885 vota.

Referuar Vendimit nr. __, datë __. __.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”, vlera e përfituar nga partitë politike të cilat nuk përfituan fonde para zgjedhjeve dhe kanë marrë jo më pak se 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi, është si më poshtë vijon:

- “Lëvizja Bashkë” – $24.547 * 94 = 2.307.418$ lekë.
- Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet” – $41.323 * 94 = 3.884.362$ lekë.
- Partia “Mundësia” – $48.952 * 94 = 4.601.488$ lekë.
- Partia “Koalicioni Euroatlantik” – $20.885 * 94 = 1.963.190$ lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronjat “k” e “n”, dhe 2, nenin 89 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimin nr. __, datë __. __.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”, si dhe Vendimin nr. 34, datë 28.8.2025, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”,

V E N D O S:

1. Të shpërndaj kompensimin financiar paszgjedhor për ato subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025, të cilat kanë marrë jo më pak se 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: __. __.2025 Nr: __
Ora: __: __



Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t'u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 maj 2025

Nr.	Emri i Partisë Politike	Fondi që përfitohet si kompensim financiar paszgjedhor (lekë)
1	Lëvizja Bashkë	2.307.418
2	Partia Lëvizja Shqipëria Bëhet	3.884.362
3	Partia Mundësia	4.601.488
4	Partia Koalicioni Euroatlantik	1.963.190
TOTALI		12.756.458

Data: __.__.2025 Nr: __
Ora: __:__



Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t'u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 maj 2025